

VENDIM
Nr. 1032, datë 16.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 371, DATË 11.6.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR DORËZIMIN E
MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE TË DOKUMENTIT TË DORËZIMIT TË
TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 9 e 20 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“9. Dorëzuesi, për çdo transfertë, u dërgon nga një kopje elektronike, nëpërmjet portalit *e-Albania*, të dokumenteve të dorëzimit, të plotësuar e të nënshkruar nga palët, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

...

20. Dokumenti i dorëzimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës në mënyrë elektronike nga dorëzuesi. Kërkesa shoqërohet me kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe një kopje të licencës III.2.B.”

2. Në pikën 21, emërtesa “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” zëvendësohet me emërtesën “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”.

3. Pikat 24 e 26 ndryshojnë, si më poshtë vijon:

“24. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit krijon një bazë të dhënash për kodet unike, të cilën ia përcjell të përditësuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, brenda datës 10 janar të çdo viti. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrimit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

- a) institucion administrues – ministria përgjegjëse për mjedisin;
- b) të dhënat parësore – lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/lëngët/ngurtë/pluhur/llum/përzier);
- c) të dhënat dytësore – numri i regjistrimit - NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;
- ç) dhënësit e informacionit – personi fizik/juridik, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- d) ndërveprimi – QKB-ja, ministria përgjegjëse për mjedisin;
- dh) personat e interesuar – personi fizik/juridik, ministria përgjegjëse për mjedisin.

...

26. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe